

**PROCESVERBAL**  
**nga mbledhja e 38-të e Këshillit të Agjencisë për**  
**Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele,**  
**të mbajtur më datë 29.09.2022**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMAA, Selver Ajdini zëvendëskryetar i Këshillit të ASHMAA, m-r Alma Mashoviq, d-r Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarë të Këshillit të Agjencisë që mungojnë: /**

**Në mbledhje ishte i pranishëm edhe d-r Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.**

**Të pranishëm nga Shërbimi profesional:** m-r Dragica Ljubevska, Goran Radunoviq, m-r Ivona Mufisheva, m-r Aleksandar Xhuvarevqi, Maja Damevska, d-r Ivana Stojanovska.

**Të pranishëm të tjerë: /**

Z. Petrushevski e hapi Mbledhjen e 38-të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:30 dhe u realizua në hapësirat e Agjencisë.

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri si vijon:

**R E N D   D I T E**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga mbledhja e 37-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më datë 29.09.2022.
2. Propozim për dhënien e lejes për realizimin e procedurës për furnizim publik për lëndën e furnizimit publik – mallit: Energji elektrike.
3. Propozim për dhënien e lejes për realizimin e procedurës për furnizim publik – shërbimit: studim i fizibilitetit për arsyetimin për vendosjen e centralit fotovoltik në selinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
4. Të ndryshme.

**Pika 1**

Këshilli i Agjencisë në pamundësi teknike për të përpiluar dokumentin e propozuar, e prolongoi miratimin e Procesverbalit nga mbledhja e 37-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më datë 29.09.2022, gjatë mbledhjeve në vazhdim.

## Pika 2

Z. Trajçevski e arsyetoi Propozimin për dhënien e lejes për realizimin e procedurës për furnizim publik për lëndën e furnizimit publik – mallit: Energji elektrike. Sqaroi se mjetet që ishin paraparë për 1 vit, për t'u furnizuar me energji elektrik janë shpenzuar për dy muaj e gjysmë. Nga 1 nëntori, Agjencia do të kyçet në EVN deri sa përmes furnizimit publik nuk zgjidhet kompani e cila do të ofrojë energji elektrike.

Krahas masave të ndërmarra për kursimin e energjisë elektrike, Agjencia arriti që të kursejë rrymë në sasinë e kilovatëve të shpenzuar për muajin gusht, por rritja e çmimit të rrymës në bursë ishte dramatike dhe llogaria e gushtit ishte më e madhe prej mbi 900 mijë denarë gjatë një muaji. Për këtë arsye propozohet që të shpallet një furnizim i ri që të mund edhe më tutje të vazhdohet furnizimi me energji elektrike.

Udhëheqësi i Sektorit të Financave dhe Logjistikës Goran Radunoviq sqaroi se llogaritë janë më të larta për shkak të rritjes së çmimit për një kilovat orë e jo për shkak të shpenzimit. Çmimi për një kilovat orë në qershor të vitit 2022 ishte 3,93 denarë, në korrik të vitit 2022 ishte 26,43 denarë, ndërsa në gusht të vitit 2022 ishte 35,27 denarë.

Z. Fidanoski tha se absolutisht do japë përkrahje për propozimin por do të apostrofojë dy momente. Momentin e parë ka arritur që ta shoh nga specifikimi teknik se gjatë muajve të verës më së shumti shpenzohet energji elektrike, sipas kësaj table, për shkak të ftohjes së sallës së serverëve dhe çështje të tjera. Shpreson se do të vazhdohet me ulje gjatë muajve të ardhshme por nuk është i sigurt se si do të jetë më tutje.

Ajo që është biseduar gjatë mbledhjes së kaluar në lidhje me pikën 3, propozimi për vendosjen e fotovoltikëve, shpreson se ajo procedurë do të shkojë shpejtë në mënyrë që ato të vihen në përdorim. Momenti i dytë është në aspekt teknik, respektivisht me vërejtje linguistike në specifikimin teknik. Në pikën 2 mbi tabelën e parë fjala “sasi apriksimative” të korigjohet si “sasi aproksimative” ose sic është në gjuhën maqedonase fjala edhe më e mirë “sasia e përafërt”.

Z. Trajçevski sqaroi se gjatë muajit gusht janë ndërmarrë masa për kursim, që në shtator edhe më shumë janë rritur, njëri ashensor është ç'kyçur nga përdorimi, ftohja aspak nuk përdoret, me çka konsiderohet se në shtator do të kemi kursimin më të madh për kilovat, por nga ana tjetër na brengos edhe rritja e çmimit të energjisë elektrike. Aq sa ASHMAA bën kursime të rrymës, nga ana tjetër edhe çmimet shkojnë më lartë, kështu që ky kursim në aspekt financiar nuk mund të vërehet.

Z. Fidanoski u pajtua me diskutimin e drejtorit duke shtuar se do të ketë kursime të kilovatëve por çmimi i rrymës “vlon” në bursa gjatë kësaj periudhe dhe nuk mund të dihet se sa do të jetë fatura përfundimtare.

Z. Petrushevski propozoi që të mendohet në drejtim të propozimit që e dha Z.Trajçev në njërin nga seancat e mëparshme për të punuar nga shtëpia.

Z. Trajçevski tha kjo mundësi po shqyrtohet, janë bërë edhe planet. Nëse ka ngrohje qendrore dhe varësisht nga fatura e rrymës për shtatorin që do të merret në tetor, e më së voni deri më 1 nëntor, 90%-95% e të punësuarve do të punojnë nga shtëpia deri sa të tjerët që nuk mund të punojnë nga shtëpia për shkak të procesit të punës, siç është arkivi dhe sektori juridik që patjetër duhet të kenë qasje në procedurat vijuese që udhëhiqen e që nuk mund të bëhet online, të punojnë në ndërrime dhe të punojnë maksimalisht në dy zyre.

Gjithsesi se mbetet mundësia nëse ka nevojë të domosdoshme për të ardhur në zyrat e punës, për nënshkrim të dokumenteve dhe realizimin e tyre. Për këtë mundësi tha se është biseduar edhe me drejtorin e Agjencisë për Rini dhe Sport dhe ata e ndajnë të njëjtin qëndrim. Kursimi në aspekt të energjisë elektrike dhe ngrohjes do të jetë dukshëm më i ulët me shpresë se çmimi i rrymës nuk do të rritet në mënyrë drastike, duke i rritur kështu edhe faturat.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha leje për realizimin e procedurës së furnizimit publik – mall: Energji elektrike.

Realizimi i procedurës së furnizimit publik për lëndën – mall: Energji elektrike është e paraparë dhe është në pajtim me Raportin vjetor për furnizime publike për vitin 2022 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ndërsa mjetet janë të siguruara me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

### **Pika 3**

Z. Trajçevski e arsyetoi Propozimin e lejes për realizimin e procedurës së furnizimit publik – shërbimi: studimi i fizibilitetit për arsyetimin e vendosjes së centralit fotovoltik në selinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Sqaroi se në pajtim me ligjin, në mënyrë që të kenë arsyetim për fazën e montimit të fotovoltikëve, paraprkisht patjetër duhet të përpilohet një studim i fizibilitetit.

Z. Trajçev tha se e përkrah propozimin dhe se në mbledhjet e kaluara u bisedua edhe për pëlqimin për vendosjen e tyre. Theksoi se ka vërejtje sikurse edhe shumë herë tjera. Nuk ka reaguuar as në mbledhjen e kaluar në lidhje me përcaktimin e pikëve për kualitet dhe çmim. Mund të kuptohet 70% për çmimin dhe 30% për kualitetin, por në atë drejtim tha se do ta shpreh qëndrimin e tij edhe pse Këshilli nuk është kompetent por ka të drejtë që ta potencojë. Tha se çmimi 30% dhe kualiteti për 70% për të është e çuditshme në këto procedura. Potencimi dhe mendimi i tij personal është se përqindja duhet të jetë më e lartë.

Z. Trajçevski tha se bëhet fjalë për një investim serioz dhe projekt serioz dhe për këtë duhet të përpilohet nga universitetet, fakultetet që e shtjellojnë këtë problematikë në mënyrë që të merret një zgjidhje kualitative dhe për këtë arsye më shumë do të vlerësohet kualiteti se sa çmimi.

Z. Petrushevski tha se ky studim jo vetëm që do t'i definojë çështjet se si do të shpenzohen këto shuma të mëdha parash prej 4 milion denarë, do të japë edhe përgjigje ndaj çështjeve tjera. Sinqerisht pret që të ulët çmimi. Sfera nuk është tejet standarde, tani gjatë disa viteve të fundit fotovoltikët janë aktuale, kështu që supozon se reagimi do të jetë më i madh, do të paraqiten më shumë kompani dhe nëse nuk kanë doktor shkencash ose magjistër prapë se prapë do ta marrin kontratën. U prononcua se do të japë përkrahje, ndërsa ajo që u tha nga z. Trajçev konsideron se është në fushëveprimin e punës së pavarur të shërbimeve dhe drejtorit, për mënyrën e realizimit të tij.

Z. Fidanoski tha se në tërësi qëndron pas këtij projekti, pret që edhe të zvogëlohet çmimi për licitimin negativ sic ka thënë z. Petrushevski. Nga përvoja me shkëmbimin e informatave për këtë temë aktuale kohëve të fundit, është se ndoshta do të përdoren edhe panele të prodhimit vendas.

Sipas disa informatave me të cilat disponon, në rajon, panelet e prodhuara në Maqedoni konsiderohen si mjaftë kualitative dhe në këtë mënyrë do të krijohet edhe përkrahja

e prodhimitarisë edhe në Maqedoni që do të jetë e konsiderueshme edhe për ekonominë. Tha se ka një sugjerim të vogël, një dilemë. Në arsyetim qëndron se panelet do të vendosen në kulmin e ndërtesës andaj do të shtonim gjithkund ku ka mundësi.

Nuk duhet që patjetër të pranohet sugjerimi i tij, p.sh nëse nuk i pengon punës së çilerit, në njërën anë të tij ka mjaftë periudha diellore gjatë ditës, andaj këtu mund të vendosen panelet. Ai tha se këtë e propozon si laik i sferës, kështu që mund që edhe personat profesional ta japin fjalën e tyre të fundit se a mundet dhe ku mundet të vendosen.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha leje për realizimin e procedurës së furnizimit publik – shërbimi: studimi i fizibilitetit për arsyetimin e vendosjes së centralit fotovoltik në selinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Realizimi i procedurës së furnizimit publik për lëndën – shërbimi: studimi i fizibilitetit për arsyetimin e vendosjes së centralit fotovoltik në selinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale është e paraparë dhe është në pajtim me Raportin vjetor për furnizime publike për vitin 2022 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ndërsa mjetet janë të siguruara me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022.

#### **Pika 4**

#### **Të ndryshme**

Në këtë pikë nuk kishte diskutim.

**Nr. 02-3548/3  
06.10.2022**

**Shkup**

**Agjencia për shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetar i Këshillit,  
Llazo PETRUSHEVSKI, d.v**